

DIXHITALIZIMI NË TREGUN E SIGURIMEVE

Abstrakt

Në këtë punim synohet të argumentohet mundësia e përfitimit të kompanive të sigurimit nga novacionet dixhitale. Argumentimi do të bëhet nëpërmjet një kërkimi teorik, të bazuar në literaturën bashkëkohore rreth dixhitalizimit dhe tregut të sigurimeve. Novacionet në teknologji rriten me një trend eksponencial, duke sjellë nevojën e adaptimit të tyre për t'i shërbyer tregjeve e shoqërisë në përgjithësi. Ato gjithmonë do të priten me dyshime nga publiku i gjerë, por me kalimin e kohës, nevojat për përmirësime, si edhe për më tepër liri nga burokracitë do të sjellin në mënyrë të pashmangshme implementimin e këtyre teknologjive. Kështu së pari do të paraqiten avancimet më të fundit në fushën e dixhitalizimit. Theksi kryesor do të vihet tek teknologjia *DL (Distributed Ledger Technology)* e njohur edhe si *blockchain* duke shpjeguar ndikimin e saj në fushën e financës dhe monedhës, si edhe debatet më bashkëkohore rreth tyre. Duke prekur fushën e financës, në një botë gjithmonë e më të pasigurt, industria e sigurimit mund të ketë një mundësi të mirë për të rritur prezencën e vet në tregje. Duke qenë se industria e sigurimeve është një hallkë, mjaft e rëndësishme e sistemit financiar, objektivi i analizës së zhvillimit të teknologjisë do të vihet në funksion të shpjegimit të impaktit të saj edhe në këtë fushë. Fillimisht do të paraqiten problemet më të shpeshta që hasin kompanitë e sigurimit, e më pas zgjidhjet që ofron dixhitalizimi. Kështu teza kryesore do të jetë se dixhitalizimi sjell një impakt pozitiv në industrinë e sigurimeve në veçanti, i reflektuar tek përmirësimi produkteve apo novatorizimi i produkteve të reja që plotësojnë nevoja të ndryshme të klientëve me një efikasitet më të lartë.

Fjalë kyçe: Novacione, Blockchain, InsurTech, FinTech, Kontratat SMART, Menaxhim risku i sigurimeve